



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBETARE E PROVIMEVE

OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË

Viti mësimor 2016-2017

Faza e dytë

Klasa 10

Model përgjigjesh të sakta

Pyetja 1

- a) Kodi i Jusitianit, shpreh qartë vizionin e perandorit bizantin, për të vendosur qeverisjen dhe funksionet e shtetit mbi bazën e ligjeve, të cilat u hartuan në mënyrë të atillë që të kuptoheshin nga të gjithë dhe të ishin të zbatueshëm. Ligjet ishin të përshtatur me zhvillimet e kohës dhe i jepnin zgjidhje thuajse të gjitha çështjeve në shoqërinë bizantine. Vlera e këtij kodi është se ai iu bë pikënisja për të drejtën kushtetuese në Evropën mesjetare e më vonë. **4 pikë**
- b) Në fushën e arkitekturës Bizanti u bë i njohur për stilin e arkitekturës së kishave dhe objekteve të kultit, por edhe të ndërtesave qeveritare e rezidencave të të pasurve. Ndër veprat më të mahnitshme të objekteve të kultit është Kisha e Shën Sofisë, që njihet si një nga objekte e rralla kulturore në botë. **2 pikë**

Pyetja 2

- a) Këshilli i Qytetarëve u bë një organ mjaft i rëndësishëm në kohën e Perikliut. Kuvendi vendoste për politikën e qeverisë dhe vendimmarrja e tij sanksionohej përmes miratimit të ligjeve. Këtij organi ju dha e drejta të thërriste për llogaridhënie nëpunësit më të lartë të shtetit. **3 pikë**
- b) Gjyqi i Jurisë vazhdonte të kryente detyrat e organizimit më të lartë gjyqësor. Për të shmangur korrupsionin e gjyqtarëve, Perikliu vendosi që ata të zgjidheshin me short dhe puna e tyre të ndahej në disa komisione. **3 pikë**
- c) Këshilli i Dhjetë Strategëve, dilte nga votimi i hapur dhe përgjegjësitë kryesore të tij ishin për mbarëvajtjen e punëve në ushtri, flotën ushtarake dhe për mbrojtjen e vendit. **1 pikë**
- d) Roli kryesor i Këshillit të Pesëqindëve ishte mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve të dala nga Kuvendi i Qytetarëve. **1 pikë**

Pyetja 3

- A- Në fushën e industrisë mund të veçojmë: rritjen e prodhimit të naftës duke ndihmuar në këtë mënyrë në rritjen e volumit të transportit hekurudhor, detar dhe tokësor të njerëzve dhe mallrave, zhvillimi i vullshëm i telekomunikacionit me shpikjen e telefonit dhe telegrafit. Në fushën e bujqësisë, përdorimi i makinerive dhe plehrave kimike, çoi në një revolucion të vërtetë agrar. **4 pikë**
- B- Në aspektin social pati ndryshime pozitive dhe negative. Pozitiv ishte fakti i rritjes së numrit të qyteteve si dhe numrit të banorëve. Rritja e shtresës së klasës së mesme, profesionistëve të ndryshëm si: inxhinierë, bankierë, teknologë etj. Por nga ana tjetër u rrit pabarazia ekonomike. Shumë njerëz ishin të punësuar në industri, por pa ndonjë siguri për jetën e tyre dhe të ardhmen në vendin ku punonin. Kishte mungesë strehimi, kushte të rënda jetese dhe pune. **4 pikë**
- C- Ndër zhvillimet politike, mund të përmendim lindjen e një rryme politike radikale siç ishte marksizmi, që i bënte thirrje punëtorëve të ngriheshin e përmbysnin me forcë klasën e pasur, për të vendosur rendin e “barabartë të punëtorëve”. Kjo ideologji filloi të fashitej me përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në shumë vende politika liberale, rivalitetit përmes zgjedhjeve zuri në jetën politike. **2 pikë**

Pyetja 4 5 pikë

- Një pengesë mund të jetë reforma në drejtësi dhe zbatimi i saj. *1 pikë*
- Zbatimi i ligjit në vend *1 pikë*
- Lufta kundër korrupsionit *1 pikë*
- Situata konfliktuale mes partive kryesore politike *1 pikë*
- Lufta kundër trafiqeve të qenieve njerëzore dhe narkotikëve *1 pikë*
- Lufta kundër krimit të organizuar *1 pikë*
- Rritja e euroskepticimit *1 pikë*
- Performanca e dobët ekonomike *1 pikë*
- Çështja e pazgjidhur e pronësisë dhe pronave në Shqipëri *1 pikë*
- Mungesa e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale etj. *1 pikë*

Shënim: nxënësi duhet të fokusohet kryesisht në pikat e mësipërme për të bërë argumentimin.

Pyetja 5

a) 2 pikë

- Në Itali ekzistonte sistemi korporativ, një model trepalësh bashkëpunimi midis punëtorëve, industrialistëve të mëdhenj dhe partisë. Ndërsa Gjermania kishte një kontroll të shtetit mbi ekonominë.
- Mungesa e një doktrine mbi diskriminimin mbi bazë racore (Itali). Urrejtja raciale ishte një nga shtyllat mbështetëse të regjimit nazist (kundër hebrenjve dhe shume grupeve të tjera të popullsisë gjermane dhe asaj të pushtuar). Ndërkohë, në doktrinën dhe politikën e regjimit fashist italian nuk ishin prezentë elemente të urrejtjes raciale, por bazohej kryesisht në koncepte nacionaliste.
- Qëndrimi ndaj burimeve tradicionale të autoritetit dhe pushtetit. Në Itali, kisha katolike kishte një pozitë shumë më të fortë dhe ishte në gjendje t'i kundërvihej politikës dhe ideologjisë fashiste më tepër se në Gjermani. Gjithashtu, edhe Shërbimi Civil dhe ushtria italiane u infiltruan nga fashistët më pak se aparati burokratik dhe ushtria gjermane nga nazistët. Në fund, në Itali, kreu i shtetit ishte mbreti që, megjithëse i përkrahu në tërësi politikën fashiste, përsëri ishte një autoritet që mund të vendosej si barrierë ndaj këtyre politikave siç edhe ndodhi me rënien e regjimit fashist. Në Gjermani, Hitleri ishte autoritet absolut dhe i padiskutueshëm deri në fund.

b) 4 pikë

- Kundërvënia ndaj ideve të demokracisë liberale dhe marksizmit
- Te dyja ishin sisteme monopartiake
- Indoktrinimi i masave
- Kultu i individit
- Qeverisja me anë të dhunës dhe terrorit.
- Mungesa e lirive dhe të drejtave të njeriut
- Nacionalizmi i skajshëm
- Kontrolli i gjithë jetës nga levat e sistemit
- Politika e jashtme agresive

Pyetja 6

a)

Popullsia autoktone ishte homogjene. Tek ajo vihet re një vazhdimësi etnokulturore. Ajo argumentohet me:

të dhëna historike

2 pikë

Në trevat ilire kishte 20 qendra banimi, si qytete, fakt që tregon për vazhdimësinë e jetës qytetare. Emri Alban rrjedh nga fisi ilir i albanëve që ka jetuar në prapatokën e Durrësit dhe që ka pasur si qendër Albanopolin (Zgërdheshin e sotëm).

të dhëna arkeologjike

2 pikë

Në disa relieve të zbuluara në vendbanimet fshatare, pasqyrohen njerëzit e punës, bujq e zejtarë me veshje tipike ilire që provon se bashkësia etnike ilirie nuk kishte pushuar së ekzistuari. Muret e kështjellave mesjetare janë ngritur mbi muret antike. Kjo flet për vazhdimësi, pa ndërprerje të jetës në këto objekte.

Meqenëse të dhënat e para për të u zbuluan në fillim në Koman të Pukës (1898) kultura arbërore njihet ndryshe edhe *si kultura e Komanit* (shek.VI-VIII). Ajo ka dy karakteristika.

- E para lidhet me trashëgiminë e vjetër. Kjo vihet re në veglat e punës dhe armët, si sëpatat, thikat e majat e shigjetave; tek stolitë, si fibulat, tokëzat etj.
- Karakteristika e dytë lidhet me kushtet e reja historike, me ndikimet e kulturave të mëdha të asaj kohe: latine e greke. Banorët kishin gjuhën e tyre e njohur (albaneska) si vazhduese e gjuhës ilire, e dallueshme nga ajo greke dhe latine.

të dhëna gjeografike

2 pikë

Në gjuhën shqipe ka një sërë huazimesh nga dialekti verior I greqishtes së lashtë. Kjo tregon se stërgjyshërit shqiptarë kanë banuar në veri të grekëve.

Po kështu kemi edhe huazime nga latinishtja e Danubit, që tregon se shqiptarët kanë qenë në kufi me banorët e këtyre trevave.

Gjuha shqipe është e pasur edhe me terminologji detare dhe ujore që dëshmon se ata kanë jetuar gjithnjë pranë detit.

të dhëna gjuhësore

2 pikë

Nga ilirishtja kanë ardhur deri sot një mijë emra njerëzish e sendesh: *Bardus – Bardhyl; Bistum= Bisht, etj*; emra qytetesh, malesh e lumenj: *Skodra; Lisis, Ulcinum, etj*.

Banorët e mëvonshëm kishin gjuhën e tyre e njohur (albaneska) si vazhduese e gjuhës ilire, e dallueshme nga ajo greke dhe latine.

të dhëna etnografike

2 pikë

Deri sot kemi disa elemente të veshjes ilire, si xhubleta, fustani e fustanella, përparja me thekë, opingat, këmisha dalmatika, kapuçi i liburnëve; shallet dardane; kapele të modës shqiptare.

Pyetja 7 5 pikë

Dyndjet sllave u shtrinë në gjithë territorin e Ilirisë. Fiset sllave, me lejen e perandorëve biznatinë, u vendosën në Ballkan dhe shumë sllavë u vendosën në Ilirinë e Veriut. Atje popullsia ilire, e rralluar nga faktorë të shumtë, nuk i bëri ballë asimilimit sllav.

Në zonat e Ilirisë së Jugut si: Preval, Dardani, Epir të Ri dhe Epir të Vjetër popullsia autoktone i bëri ballë asimilimit sllav. Arsyt kryesore për këtë ishin:

- Iliria e Jugut ishte zonë ekonomike e zhvilluar, me qendra të mëdha qytetare.
- Nëpër territorin e saj kalonin rrugë të mëdha tregtare.
- Popullsia ishte më kompakte dhe kishte nivel më të lartë kulturor.
- Terreni ishte malor dhe bregdeti kishte shumë baza të fortifikuara.
- Në këtë pjesë ishin ngritur formacionet shtetërore ilire.

Sllavët që depërtuan në Ilirinë e Jugut sllavët u asimiluan me kalimin e kohës.